

1 Hyrje

Kjo fletëpalosje ka për qëllim t'i ofrojë operatorëve dhe qiradhënësve të bordeleve, veprimtarive të llojit të bordeleve dhe banesave një pasqyrë të trajtimit të së drejtës tatimore lidhur me veprimtarinë tuaj.

Qarkullimi dhe të ardhurat e operatorëve dhe qiradhënësve në ambientin rozë i nënshtrohen tatimit në bazë të rregullave dhe ligjeve tatimore ne fuqi.

Për sa i përket tatimit duhet të bëhet dallimi në mes qiradhënies, gjegjësisht dhënies në shfrytëzim, dhe operimit privat të një veprimtarie të llojit të bordeleve.

Shpeshherë operatorët dhe qiradhënësit e dhomave në bordele- dhe të automjeteve besojnë se me prostitutat kanë vetëm marrëdhënie të qiradhënies.

Sa i përket vendosjes së shkallës të së drejtës tatimore, për këtë është vendimtar krijimi faktik i raporteve kontraktuese si dhe pasqyra e përgjithshme e operatorit

2 Operatori i një biznesi prostitucioni

Operator është personi, i cili paraqitet si pronar i një bordeli, një veprimtarie të llojit të bordelit, apo një banese model (për shembull nëpërmjet reklamimit përkatës) dhe ofron shërbime të ndryshme të kërkuara nga klienti, duke përfshirë edhe ofrimin e shërbimeve seksuale.

Obligimi i regjistrimit

Të ardhurat dhe shpenzimet duhet të deklarohen në mënyrë të plotë, të rregullt dhe me kohë. Të ardhurat ne formën e parave të thata duhet të regjistrohen çdo ditë.

Të gjitha regjistrimet dhe faturat përkatëse duhet të ruhen dhjetë vjetë.

Obligimi i deklarimit

Në zyrën e Financave duhet të paraqiten këto deklarime taksash:

- **Çdo muaj** (për muajin pararendës):
 - një njoftim paraprak për taksën e qarkullimit
 - gjegjësisht si një punëdhënës, një njoftim të taksës për pagat
- **Çdo vit** (për vitin pararendës):
 - një deklaram vjetor tatimor të qarkullimit,
 - një deklaram tatimor mbi të ardhurat,
 - një përcaktim të fitimit
 - dhe gjegjësisht një deklaram mbi tatimin e biznesit

Këto deklarata tatimore duhet të dërgohen në zyrën e tatimeve në mënyrë elektronike. Në rastet e vështirësive, këto mund të dorëzohen edhe në formë letre. **Transmetimi elektronik është pa pagesë nëpërmjet www.elster.de/eportal.** Atje do të gjeni udhëzime të hollësishme për krijimin e një llogarie përdoruesi.

Tatimi mbi qarkullimin

Operatori është sipërmarrës shërbimi.

Ky është përgjegjës për te **gjithë qarkullimin**, i cili është i ndërlidhur me biznesin. Këtu bëjnë pjesë krahas qarkullimit nga qiradhënia, pagesa e hyrjes, shitja e pijeve dhe shitja e mjeteve ndihmëse, si dhe **qarkullimi i prostitutave në 100%**.

Shumat paratimore mund të merren në konsideratë vetëm nëse paraqiten faturat e rregullta të të ardhurave.

Tatimi mbi të ardhurat

Të ardhurat e fituara të operatorit i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat si të ardhura nga veprimtaria sipërmarrëse.

Operatori është përgjegjës **për të ardhurat e përgjithshme**, të cilat janë të ndërlidhura me biznesin e prostitucionit. Tek të ardhurat e veprimtarisë sipërmarrëse bëjnë pjesë krahas të ardhurave nga qiradhënia pagesa e hyrjes, shitja e pijeve dhe shitja e mjeteve ndihmëse edhe pagesat e klientëve kundrejt prostitutave në 100%.

Pagesat e prostitutave janë shpenzime të sipërmarrjes së operatorit.

Nëse operatori nuk i deklaron emrat e persona-ve, të cilët punojnë në sipërmarrjen e tij, administrata tatimore mund të mos i regjistrojë ndalesat e shpenzimeve si shpenzime të sipërmarrjes.

Prostitutat mund të ofrojnë shërbimet e tyre ndaj mysafirëve si nësipërmarrëse për operatorin, ose mund të kenë raporte pune me operatorin.

Prostitutat janë punonjëse, nëse janë të punësuar në një organizatë vepruese si dhe nëse i nënshtrohen udhësimeve të një operatori, për sa i përket kohës, kohëzgjatjes, vendit dhe llojit të kryerjes së punës.

Tatimi i biznesit

Nëse fitimi i tatueshëm është më shumë se 24,500 € (të ardhurat e biznesit) duke marrë parasysh alokimet dhe vendbanimet e caktuara, atëherë tatimi i biznesit gjithashtu rritet.

Tatimi mbi pagën dhe sigurimet sociale

Operatori është i obliguar, që si punëdhënës të deklarojë tatimin mbi pagën në administratën tatimore për (Prostitutat, personelin e banakut, personelin e pastrimit, shërbyesit e sigurimit, mirëmbjatesit). Karakteristikat elektronike të zbritjes së tatimit mbi të ardhurat (ELStAM) të punonjësve, në bazë të të cilave hetohet shuma e tatimit të pagave që duhet paguar, duhet të merret nga transmetimi i të dhënave në Zyrën Qëndrore Federale të Tatimeve dhe të kalohet në llogarinë e pagave për punonjës.

Kontributet e sigurimeve shoqërore paguhen në arkën e sigurimeve të shëndetësisë përkatëse të punonjësve.

3 Qiradhënia ndaj prostitutave

Qiradhënie konsiderohet dhënia e një objekti, shpeshherë një objekti banimi, kundrejt pagesës së qirasë, apo shërbimeve të tjera të kërkuara.

Nësë qiradhënësi i objekteve paraqitet nga jashtë si ofrues i shërbimeve, të cilat kërkohen aty (p.sh. nëpërmjet reklamimit), atëherë ai konsiderohet si operator. (shih pikën 2).

Tatimi mbi qarkullim

Qiradhënia është subjekt i obligimit të tatimit mbi qarkullim, nëse

- Objektet jepen me qira për kohë të shkurtër ose
- Qiradhënësi nëpërmjet masave organizative e lehtëson, apo nxit kontaktin me klientët (p.sh. objektin kontaktues).

Tatimi mbi pagë

Për shërbimet qiradhënësi duhet t'u lëshojë një faturë prostitutave apo të lidhë një kontratë qeradhënie me shkrim. Një duplikat i këtyre dokumenteve duhet të ruhet dhjetë vjet. Fatura apo kontrata e qeradhënies duhet të përmbajë:

- Emrin e plotë dhe adresën e plotë të qiradhënësit dhe të prostitutave,
- Numrin tatimor të qiradhënësit,
- Datën e lëshimit,
- Numrin vijues së faturës,
- Llojin dhe kohën e shërbimit,
- Pagën si dhe kuotën tatimore dhe shumën tatuese përkatëse mbi pagesën.

Nëse qiradhënësi nuk lëshon faturë, apo nuk lidhë kontratë mbi qiradhënien brënda kohës dhe nuk e ruan dokumentacionin dhjetë vjet, atëherë administrata tatimore mund të dënojë atë me gjobë për shkelje të rregullave.

Qiradhënësi realizon në parim të ardhura nga qiradhënia dhe dhënia në shfrytëzim. Qiradhënësi duhet të ketë parasyshë rregullat e mësipërme.

Për pyetje të tjera drejtohuni ju lutemi në administratën tatimore vendore, ose në Info-Hotline të administratave tatimore të Niedersachsen

e Zyrave të Financave të Landit Niedersachsen

Info – Hotline

0800 – 998 0 997

Pa pagesë

Nga e hëna në të enjte Ora 08:00 -18:00
Të premten Ora 08:00 -15:00

(Përveç ditëve të festave zyrtare)


Botuesi:

- Senatorja e Financave Bremen
- Zyra e Financave Hamburg - Administrata tatimore -
- Ministria e Financave Mecklenburg-Vorpommern
- Drejtorja e Financave Niedersachsen
- Ministria e Financave e Landit të Sachsen-Anhalt
- Ministria e Financave të Landit Schleswig-Holstein

Aktuale që nga: Qershor 2019

Informacione themelore:

Tatueshmëria e operatorëve dhe banesave në ambientin rozë



Bremen



Hamburg



Mecklenburg-Vorpommern



Niedersachsen



Sachsen-Anhalt



Schleswig-Holstein